



C.nr.483/12

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** Departamenti i përgjithshëm –  
Divizioni Civil, gjyqtari gjyqtari Enes Mehmeti me bashkëpunëtorin profesional Alban  
Beqiri, në çështjen juridike të paditëses [REDAKTUE]  
Ferizaj, të cilën e përfaqëson [REDAKTUE] me autorizim, kundër të paditurit, [REDAKTUE]  
[REDAKTUE] nga [REDAKTUE] Komuna e Ferizajt, për pagimin e borxhit vlera e kontestit 1.909,98 €  
pas seancës publike të mbajtur më 09.12.2014, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses  
dhe në prezencën e të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M  
(në bazë të pohimit)

**ABVOVQHET** në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses.

**DETYROHET** i padituri [REDACTED] që paditëses t'i paguajë shumën prej 1.909,98 €, në emër të borxhit të cilin e ka krijuar ne rastin e shpenzimit të energjisë elektrike, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 40 €, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit me dhunë

Arsy etim

Paditësja, [REDACTED] në këtë  
Gjykatë me dt.16.07.2012, ka ushtruar propozim për përbartim ndaj të paditurit si  
debitor për pagesën e borxhit në lartësi prej 1.909,98 €, në bazë të dokumentit autentik  
duke provuar me faturën nr.DFE-47962, të dt.20.05.2012.

Kjo gjykatë me aktvendim E.nr. 1104/12, të dt.10.08.2012, ka lejuar përbartimin ndaj të paditurit si debitor, i padituri në aktvendim mbi lejimin e përbartimit në afatin e paraparë ligjor me dt.12.09.2012, ka parashtruar kundërshtim me arsyetim se lartësia e bërrubit është e lartë është bërë ndonjë gabim teknik dhe jam ngarkuar paushall.

Përsaqësuesja e paditësës në fjalën përfundimtare ka dekluaruar mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë për përbushjen e borxhit – pagesës së borxhit në shumë prej 1,909.98€, në emër të shpenzimeve elektrike të cilat i ka krijuar i padituri, dhe ka kârkuar nga ana e givkatës që ta aprovon padinë dhe kërkesë padinë si të bazuar.

Iko kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

I padituri në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se është e vërtet se e ka shpenzuar energjinë elektrike dhe e ka pranuar borxhin se e ka shpenzuar vetë por tani për tani nuk ka mundësi ta paguaj për shkak të kushteve të vështira ekonomike pasi që është pensionist.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara konstatoi se ekziston detyrimi i të paditurit që paditëses t'i paguajë borxhin në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, megjithëse i padituri me kurfarë prove nuk argumentoi të kundërtën.



Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga provat e administruara u vërtetua se i padituri i ka borxh paditëses shumën prej 1,909.98€, e cila shihet edhe nga transaksioni i konsumatorit e cila gjendet në shkresat e lëndës si dhe vetë pohimi i të paditurit lidhur me shumën që është objekt i këtij kontesti.

Nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës është e pakontestueshme se palët ndërgjyqëse janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete për furnizim, shfrytëzim të energjisë elektrike dhe pagesën e borxhit të shpenzuar të energjisë elektrike në kuptim të nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara-faturat dhe pohimet e vetë të paditurit në seancën e shqyrimit gjyqësor.


Andaj, pasi që i padituri e ka pranuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses gjykata zbatoj dispozitat e nenit 148 të LPK-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 20 € dhe aktgjykim prej, 20 €, gjithësej në lartësi prej 40 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
C.nr. 483/12 më dt.09.12.2014**

Gjyqtari:  
Enes Mehmeti



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSENZA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më  
Dana



- CA.nr. 315/15

2018